

VENDIM
Nr. 63, datë 24.11.2021

**PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR KËRKESAT
MINIMALE TË SIGURISË NË AMBIENTET KU KRYHEN VEPRIMTARITË
BANKARE DHE FINANCIARE, DHE PËR TRANSPORTIN E VLERAVE
MONETARE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja “b”, nenit 12, shkronja “a” dhe nenit 70, pika 1, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të neneve 57, pika 2, 58 dhe 126, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 55/2020, datë 30.4.2020, “Për shërbimet e pagesave”; si dhe të nenit 61, shkronja “b” dhe nenit 65, pika 4, të ligjit nr. 52/2016, datë 19.5.2016, “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Departamentit të Sigurimit dhe Mbrojtjes,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për kërkesat minimale të sigurisë në ambientet në të cilat kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare, dhe për transportin e vlerave monetare”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 67, datë 1.6.2016, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) në nenin 2, pas togfjalëshit “*“Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar,*”, hiqet togfjalëshi “*si dhe*” dhe pas togfjalëshit “*të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,*”, shtohet togfjalëshi “*të ligjit nr. 55/2020, datë 30.4.2020, “Për shërbimet e pagesave”;*”;

b) në nenin 3, pas togfjalëshit “*degët e bankave të huaja*”, shtohet togfjalëshi “*institucionet e pagesave, institucionet e parasë elektronike,*”;

c) në nenin 4, pika 1, pas togfjalëshit “*ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”*” shtohet togfjalëshi “*, në nenin 5, të ligjit nr. 55/2020, datë 30.4.2020, “Për shërbimet e pagesave”;*”;

d) në nenin 4, pika 2, shkronja “a” ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

“**Agjent** - ka të njëjtin kuptim me termin “agjent” të përkufizuar në ligjin “Për shërbimet e pagesave” dhe me termin “agjent i institucionit të parasë elektronike” të përkufizuar në rregulloren “Për licencimin e institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike, si dhe për regjistrimin e ofruesve të shërbimeve të pagesave,”;

e) në nenin 4, pika 2, shkronja “i” ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

“**ATM** - (Automated Teller Machine) - ka të njëjtin kuptim me termin e përkufizuar në ligjin “Për shërbimet e pagesave,”;

f) në nenin 6, pas pikës 5, shtohet pika 6 me përmbajtjen e mëposhtme:

“Bankat, vetëm në cilësinë e ofruesit të shërbimeve të pagesave, që kryejnë veprimtari me agjentë siç parashikohet në ligjin “Për shërbimet e pagesave”, janë përgjegjëse për verifikimin e zbatimit të kërkesave të kësaj rregulloreje nga këta të fundit.”;

g) titulli i kreut III, ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

“Kërkesat minimale të sigurisë në ambientet e subjekteve financiare jobanka, zyrtare të këmbimit valutor, shoqërive të kursim-kreditit dhe unioneve të tyre, institucioneve të pagesave, institucioneve të parasë elektronike, që kryejnë veprimtari me sportel dhe/ose me agjentë”;

h) në nenin 13, pika 1, pas togfjalëshit “*shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre,*”, shtohet togfjalëshi “*institucionet e pagesave, institucionet e parasë elektronike dhe*”;

i) në nenin 13, pika 2, pas togfjalëshit “*zyrat e këmbimit valutor*”, shtohet togfjalëshi “*institucionet e pagesave, institucionet e parasë elektronike*”;

j) në nenin 13, pika 3, pas togfjalëshit “*shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre*”, shtohet togfjalëshi “*institucionet e pagesave, institucionet e parasë elektronike dhe*”;

k) në nenin 13, paragrafi 5, pas togfjalëshit “*shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre*”, shtohet togfjalëshi “*, institucionet e pagesave, institucionet e parasë elektronike*”;

l) në nenin 13, pika 6, pas togfjalëshit “*Subjektet financiare jobanka*”, shtohet togfjalëshi “*, institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike*”;

m) në nenin 15, pas togfjalëshit “*ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”*”, shtohet togfjalëshi “*, në ligjin nr. 55/2020, datë 30.4.2020, “Për shërbimet e pagesave”*”.

2. Ngarkohen Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Sigurimit dhe Mbrojtjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 janar 2022.

KRYETAR
Gent Sejko